



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Fizikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë asistent lektor.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të jetë i kategorisë asistent lektor. Diplomat Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në *fizikë* të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
2. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në fizikë me notë mesatare mbi 8.
3. Të zotërojë dhe të vërtetuar të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
6. Të jetë i aftë për punë.

Kritere të veçanta.

1. Preferohet të ketë pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe publikime të artikujve shkencorë të botuara në revista shkencore ose Proceedings Books.
2. Të ketë përvojë pune në Institucione Arsimi të Lartë.
3. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**23.10.2023 - 01.11.2023**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (23.10.2023 - 01.11.2023) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *asistent lektor - Fizikë*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (03.11.2023 – 13.11.2023). Kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.